

Raporti vjetor 2024



Inspektorati Policor i Kosovës

©Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet. Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga “Dëshmorët e Gollakut” nr.402, Hajvali-Prishtinë,
Kosovë;

Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201

E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

inspektoratipolicor@gmail.com

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
DBI	Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim
DPBÇLI	Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DI	Departamenti i Inspektimeve
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të Kaluarës
EPAC	European Partners Against Corruption
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradave
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PPKK	Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	5
2.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	6
3.	HYRJE.....	7
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	9-15
6.	HETIMET PENALE	16-28
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE	29-38
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	39-48
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	49-52

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i pavarur nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/54 dhe Urdhërësës Administrative nr.2006/9, si Agjenci Ekzekutive në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe

zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të nderuar qytetarë,

Me kënaqësi prezantojmë Raportin vjetor për vitin 2024, të karakterizuar me plotë sfida dhe suksese të rëndësishme. Falënderoj të gjithë punonjësit e agjencisë sonë për përkushtimin në zbatim të mandateve dhe vizionit për të siguruar një shërbim policor efikas e efektiv, gjithnjë në shërbim të qytetarëve të vendit. Çmojmë pa masë bashkëpunimin e qytetarëve nga të gjitha anët pa dallim, në adresimin e shqetësimeve të tyre, për të orientuar në rrugën e duhur zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike e profesionale. I gjithë ky angazhim, që ka rezultuar me ngritje të besimit në ne, është rezultat edhe i mbështetjes së partnerëve, të cilët në çdo kohë nuk kanë kursyer përkrahjen e tyre për ne.

Viti që lëmë pas është karakterizuar në vazhdimësi me angazhime në të gjitha drejtimet. Ka pasur një ngritje të ankesave të qytetarëve, si rezultat i vetëdijësimit qytetar për të adresuar çdo shqetësim të tyre, por edhe të besimit në agjencinë tonë, gjë që na motivon se jemi duke bërë punën e duhur në mbikëqyrje të punës policore. Hetimet penale kanë vazhduar në drejtim të luftimit e dokumentimit të veprave penale, me fokus të veçantë në fushën e korrupsionit, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, etj. Inspektimet janë treguar instrument i suksesshëm për të nxitur menaxhimin efektiv dhe efikas, duke besuar që rekomandimet për strukturat policore, ndihmojnë në ngritjen e performancës dhe profesionalizmit policor.



Kryeshefi Ekzekutiv Kushtrim HODAJ

IPK tanimë ka hapur horizontet e bashkëpunimit vendor, rajonal e ndërkombëtar. Me Prokurorinë e Shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe agjencitë tjera me të cilat kemi lidhur urat e bashkëpunimit, ka pasur një komunikim dhe përkrahje institucionale. Me agjencitë homologe të rajonit ka pasur një bashkëpunim të shtuar dhe angazhimet në kuadër të Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore, vetëm se e kanë vënë në pah një rol prioritar të agjencisë sonë në luftimin e krimit, ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet palëve. IPK vazhdon të jetë aktive në Partneritetin Evropian Kundër Korrupsionit, si mekanizëm i Këshillit të Evropës, përmes përfaqësimit në konferenca, punëtori dhe vizita studimore. Ka disa vite që IPK është anëtare e Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (SHBA) dhe në kuadër të konferencës vjetore të realizuar këtë vit, IPK ka prezantuar edhe sukseset në luftën kundër korrupsionit.

Si gjithëherë, edhe këtë vit IPK ka vazhduar të mbështetet nga partnerët ndërkombëtar, ku kontributi i tyre ka vend të rëndësishëm në sukseset tona. ICITAP, OSBE, EULEX, HAPE nuk kanë kursyer të kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve tona operationale përmes programeve të trajnimeve dhe mbështetjes logjistike. IPK çmon këtë përkushtim, duke besuar se kjo përkrahje do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Për fund, të gjithë qytetarëve iu drejtohem me zotimin se agjencia jonë do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në adresimin e shqetësimeve tuaja, në misionin e përbashkët të shoqërisë për të zhvilluar një shërbim policor me standarde evropiane. Ju sigurojmë se misioni i tillë është i mundshëm nëse vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe e kaluara tregon se ne kemi mbështetjen tuaj.

Me respekt!

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën janar - dhjetor 2024, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarët mbi punën që bëjmë, IPK-ja praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësi dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve duke përfshirë krahasimin e trendëve të rasteve ndër vite, mënyrën e trajtimit të ankesave, ngarkesën ndër muaj, etj.

Përveç tjerash Raporti ynë ofron informacione shtesë edhe për disa aktivitete të rëndësishme të IPK-së gjatë vitit 2024, si vizitën e Kryeministrit Kurti në IPK, organizimin në Prizren të Konferencës Rajonale tre ditore, organizimin e seminarit dhe vizitës studimore tri-ditore me përfaqësues të agjencive mbikëqyrëse policore nga tri shtete të rajonit: Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, prezantimin nga IPK-ja në konferencën vjetore të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Uashington etj.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t'iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **2046** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **34%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **65%** i kemi orientuar për hetim disiplinor Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq-menaxhimit policor:

- Kemi hetuar **190** të dyshuar (175 punonjës policorë dhe 15 qytetarë);
- Kemi ngritur **86** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **22** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **91** punonjësve policorë.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam dymbëdhjetë **(12)** inspektime të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **qindra** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj., dhe realizuam dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **63** rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve dhe transparencës për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **100** komunikata dhe publikime të ndryshme;
- Ofruam informacione për medie në mbi **180** kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OIQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore.

5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (tutje si DMA) është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së, që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtresë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grup i interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtresa ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë:

- të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme;
- të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime;
- të sigurojë që informatat që posedon IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse;
- të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

Faktet kyçe (indiktorët):

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E ANKESAVE

- Trajtuar 2046 ankesa dhe informacione të ndryshme;
- 693 ankesa i kualifikuam si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale dhe i proceduam në Departamentin e Hetimeve të IPK-së;
- 1338 ankesa i kualifikuam se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore, dhe i proceduam në Divizionin e Hetimeve të Brendshme në kuadër të Policisë së Kosovës.


Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:

- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve,

DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës.


¹ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

² Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017



Pranimi i ankesave

Gjatë vitit 2024 DMA-ja ka administruar gjithsej 2046 ankesa të natyrave të ndryshme. Sipas të dhënave statistikore të tri viteve të fundit, vihet re një rritje e dukshme e trendit të ankesave. Kjo rritje e vazhdueshme e numrit të ankesave tregon një tendencë të konsoliduar, e cila besohet të jetë pasojë e rritjes së vetëdijes dhe besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucionit tonë, fakt që mbështetet edhe nga matjet e kryera nga institucione të pavarura dhe të besueshme. Ky rezultat i lartë është pasqyrë e angazhimit të vazhdueshëm të punonjësve të Inspektoratit të Policor të Kosovës (IPK), të cilët kontribuojnë në përmbushjen e mandateve të tyre, promovimin e vlerave dhe sensibilizimin e qytetarëve për raportimin e ankesave.



Mënyrat e pranimi të ankesave

Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme për të proceduar me ankesat e tyre. Sipas statistikave të viteve të fundit, shihet se edhe këtë vit qytetarët kanë preferuar në masë të madhe dorëzimin e ankesave përmes postës elektronike, për shkak të përdorimit gjithnjë e më të gjerë të teknologjisë informative. Po ashtu, dorëzimi i ankesave në formë fizike dhe përmes postës tradicionale janë ndër opsionet më të shpeshta që qytetarët zgjedhin (shih tabelën).


Tabela nr. 1-Të dhëna përmbledhëse mbi numrin e ankesave dhe mënyrat e paraqitjes			
Nr.	Mënyrat e parashtrimit të ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike (vebsajt, email, rrjeteve sociale)	797	39%
2	Ankesat e pranuar fizikisht në IPK dhe zyrat rajonale	630	30.8%
3	Ankesa të pranuar përmes postës	180	8.7%
4	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve dhe Departamenti	147	7.2%
5	Inicime nga DMA	4	0.2%
6	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera	34	1.7%
7	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	172	8.4%
8	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	82	4.0%
	Gjithsej	2046	100%

Bazuar në të dhënat nga tabela e mësipërme, rezulton se 1,758 ankesa, ose 85.9% janë pranuar përmes mundësive të ofruara nga IPK, ndërsa përmes Policisë së Kosovës janë pranuar 172 ankesa, ose 8.4%. Po ashtu, janë 82 raste inicime të brendshme nga Policia e Kosovës, që përbëjnë 4.0%, ndërsa 34 ankesa, ose 1.7%, janë pranuar nga institucione të tjera.

Ankesa të pranuar nga zyrat rajonale të IPK-së janë si më poshtë: 40 ankesa në Gjilan, 11 ankesa në Prizren dhe 19 ankesa në Mitrovicën e Veriut, gjithsej 70 ankesa. Pra, vërehet një rritje e pranimit të ankesave në zyrën rajonale të Mitrovicës së Veriut.

Kualifikimi i ankesave

Pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesave të pranuar, është bërë kualifikimi i ankesave, i cili është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Në lidhje me ankesat e cilësuar si shkelje disiplinore, janë dërguar 1,338 njoftime zyrtare me shkrim qytetarëve, për t'i informuar se ankesa e tyre është transferuar për hetim të mëtejshëm tek autoritetet kompetente brenda Policisë së Kosovës.

Përkatësia gjinore e ankuesve

Sipas të dhënave të DMA-së për vitin 2024, gjithsej 1,638 ankesa janë paraqitur nga individë të gjinisë mashkullore, ndërsa 232 ankesa janë adresuar nga individë të gjinisë femërore. Për 176 ankesa të tjera, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet gjinia, për shkak të mënyrës në të cilën janë ushtruar ankesat, përfshirë iniciimet zyrtare nga DMA-ja, iniciimet e brendshme, ankesat anonime dhe ato që kanë ardhur nga institucione të tjera.

DMA ka pasur interes të analizojë ndryshimin e raportit gjinor të personave që kanë adresuar ankesa në IPK dhe është vënë re një rritje e lehtë e numrit të ankesave nga gjinia femërore në krahasim me vitet paraprake (shih tabelën).

Tabela nr. 2 -Të dhëna përmblledhëse mbi gjininë e ankuesve për tri vitet e fundit (2022-							
Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2022	%	2023	%	2024	%
1	Meshkuj	1.351	79.6	1356	79.9	1638	80.1
2	Femra	211	12.4	208	12.3	232	11.3
3	E panjohur	135	8	133	7.8	176	8.6
	Gjithsej	1.697	100%	1.697	100%	2046	100%

Përkatësia etnike e ankuesve

Në vitin 2024, nga gjithsej 2046 ankesa, 1770 prej tyre janë paraqitur nga individë të përkatësisë shqiptare, 81 nga individë të përkatësisë serbe, 14 nga ata të përkatësisë boshnjake dhe 5 nga shtetas të huaj. Për 176 ankesa të tjera të pranuar në IPK, nuk është e mundur të përcaktohet përkatësia etnike e ankuesve, pasi këto janë lidhur me iniciime zyrtare nga DMA, iniciime të brendshme, ankesa anonime, si dhe ankesa nga institucione të tjera. Gjithashtu, DMA ka shfaqur interes për të analizuar ndryshimet në raportin etnik të individëve që kanë paraqitur ankesa në IPK.

Bazuar në të dhënat tona zyrtare, IPK gëzon besueshmëri të gjerë tek të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Për këtë qëllim, janë realizuar analiza dhe krahasime të trendëve të ankesave nga grupe të ndryshme etnike gjatë tre viteve të fundit, ku vihet re një rritje e lehtë e numrit të ankesave nga komunitetet jo shumicë në Kosovë (shih tabelën).

Tabela nr.3-Të dhënat përmblledhëse mbi përkatësinë etnike të ankuesve (2022-2024)							
Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2022	%	2023	%	2024	%
1	Shqiptar	1481	87.3	1504	88.6	1770	86.5
2	Serb	71	4.2	52	3.1	81	4.0
3	Turq	0	-	0	-	0	-
4	Boshnjak	8	0.5	6	0.4	14	0.7
5	RAE	0	-	0	-	0	-
6	Të tjerë të huaj	2	0.1	2	0.1	5	0.2
7	E panjohur	135	8	133	7.8	176	8.6
	Gjithsej	1697	100%	1697	100%	2046	100%

Ngarkesa mujore me ankesa

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2024 ka qenë muaji Tetor, me 228 ankesa të pranuar, kurse muaji më pak i ngarkuar është muaji Nëntor, me 136 ankesa të pranuar (shih tabelën).

Tabela nr. 4 - Të dhëna përmbledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas muajve (2022-2024)							
Nr.	Muaji	2022	%	2023	%	2024	%
1	Janar	124	7.3	98	5.8	140	6.8
2	Shkurt	149	8.8	126	7.4	160	7.8
3	Mars	168	9.9	119	7.0	162	7.9
4	Prill	128	7.5	92	5.4	161	7.9
5	Maj	138	8.1	144	8.5	170	8.3
6	Qershor	174	10.3	143	8.3	148	7.2
7	Korrik	126	7.4	156	9.2	204	10.0
8	Gusht	170	10.0	201	11.8	192	9.4
9	Shtator	128	7.5	185	10.9	187	9.1
10	Tetor	115	6.8	168	9.9	228	11.1
11	Nëntor	133	7.8	128	7.5	136	6.6
12	Dhjetor	144	8.5	137	8.1	158	7.7
	Gjithsej	1697	100%	1697	100%	2046	100%

Numri i ankesave në raport me drejtoritë rajonale

Të dhënat e administruara nga DMA mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore për punonjësit e të cilave ka pasur ankesa të qytetarëve. Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe arrijnë në 46.3 % të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa, më së paku ankesa ka për Stacionin Policor – Aeroporti i Prishtinës 0.1 % (shih tabelën).

Tabela nr. 5 -Të dhëna përmbledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas rajoneve			
Nr.	Drejtoritë	Numri	%
1	DRP - Prishtinë	948	46.3
2	DRP - Pejë	174	8.6
3	DRP - Ferizaj	172	8.4
4	DRP - Prizren	170	8.3
5	DRP - Gjiilan	201	9.9
6	DRP - Mitrovicë Jugu	155	7.6
7	DRP - Mitrovicë Veriu	60	2.9
8	DRP - Gjakovë	131	6.4
9	DRPK - Veriu	8	0.4
10	DRPK - Lindja	11	0.5
11	DRPK - Perëndimi	13	0.6
12	St. Policor - Aeroporti	3	0.1
	Gjithsej	2046	100%

Natyra e ankesave të paraqitura

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur natyra e ankesave të parashtruara pas kualifikimit fillestar nga DMA-ja (shih tabelën).

Tabela nr. 6 Ankesat e pranuar në bazë dyshimi për vepra penale		
Nr.	Vepra penale	Nr. i rasteve
1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	163
2	Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës	196
3	Manipulim me prova	68
4	Kanosje	48
5	Lëndim trupor	13
6	Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	12
7	Sulm	14
8	Ushtrim ndikimi	21
9	Rrezikim i trafikut publik	9
10	Moslajmërim i veprës penale	11
11	Dhunë familje	16
12	Zbulim i fshehtësisë zyrtare	10
13	Të tjera	112
Gjithsej		693

Tabela nr. 7 Ankesat e pranuar në bazë dyshimi për shkelje disiplinore		
Nr.	Shkelja disiplinore	Nr. i rasteve
1	Sjellje e rëndë diskredituese	917
2	Sjellje e lehtë diskredituese	357
3	Shkelje e rëndë e autorizimit	46
4	Përdorimi i tepërt i forcës	5
5	Korrupsion dhe konflikt interesi	1
6	Të tjera	12
Gjithsej		1338

6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve (D.H) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është:

- Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
- Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë;
- Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutive etj.³

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë:

- Kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë, zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuara nga autoriteti kompetent;
- Zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore;
- Bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative;
- Nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale, ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente;
- Siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vendngjarja)⁴.

Hetuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 41 punonjës (Udhëheqës i Departamentit, udhëheqës të divizioneve dhe hetues).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE


Departamenti i Hetimeve u angazhuan në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq menaxhimit policor:

- Kemi hetuar 175 punonjës policorë dhe 15 qytetarë;
- Kemi ngritur 81 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar 22 punonjës dhe qytetarë me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme;
- Kemi rekomanduar suspendimin e 91 punonjësve policorë.

³ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).


⁴ Neni 6 i Rregullores (MPB) nr.01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

Raporti përmbledhës për hetimet, përmban aktivitete të realizuara në suaza të detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për Departamentin e Hetimeve dhe të dhënat e gjeneruara që posedon DH. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2024, subjekt i hetimit penal nga IPK, kanë qenë gjithsej 190 persona (175 punonjës policor dhe 15 qytetar), shprehur në përqindje 1.8% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë që janë hetuar nën dyshimin se janë përfshirë në veprimtari penale.



Viti 2024 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në, bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin e kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, të suspenduarve etj.


Në vitin 2024, DH ka pranuar 698 raste përmes Departamentit për Menaxhimin e Ankesave në kuadër të IPK-së, ndërsa 198 raste kanë vazhduar trajtimin nga vitet paraprake në vitin 2024, kurse DH pas zhvillimit të hetimeve penale 51 raste i ka iniciuar për hetim disiplinor. Departamenti i Hetimeve ka trajtuar gjithsej 947 raste, duke përfshirë rastet e bartura nga vitet paraprake si dhe rastet e pranura në këtë vit, të dhënat pasqyrohen në diagramin nr.4 si më poshtë.



Totali prej 947 raste të trajtuara në vitin 2024 gjeneron si në vijim:

- 406 raste nën hetim paraprak, në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm janë proceduar në DHB-PK, për hetim të mëtutjeshëm administrativo – disiplinor;
- 181 raste janë parashtruar në Prokurorinë e Shtetit;
- 53 raste janë trajtuar në aspektin disiplinor administrativ⁵;
- 30 raste kanë mbetur në nivel informate të proceduar në DIA-DH;
- 42 raste janë bashkangjitur rasteve paraprake;
- 4 raste janë kthyer në PK, për hetim të mëtutjeshëm bazuar në mandatin ligjor;
- 23 raste, pas zhvillimit të hetimeve paraprake janë mbyllur në Arkiv-IPK;
- 208 raste, kanë mbetur në proces që vazhdojnë trajtimin në vitin 2025 (176 nën hetim paraprak, 30 nën hetim penal dhe 2 nën hetim administrativo disiplinor).


Të gjitha të dhënat e lartcekura janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:



⁵ LIGJI Nr. 03/L-231, Neni 2, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 14.5

IPK-DH gjatë vitit 2024, në Prokurorinë e Shtetit ka parashtruar 86 raste me Kallëzim Penal, 37 raste me Raport të Veçantë dhe 58 raste me Raport Informues (10 raste nën hetim penal dhe 48 raste në fazën e hetimit paraprak)⁶.

Bazuar në diagramin në vijim, shihet një ngritje e rasteve me Kallëzim Penal për 14% dhe një ngritje e lehtë e Raporteve Informues për 3.4% në vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak, gjithashtu shihet një rënie e dukshme e rasteve me Raport të Veçantë për 31.4% nga viti paraprak.



Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH ka kryer arrestimin e të dyshuarve për përfshirje në veprimtari penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Republikës të Kosovës.


Bazuar në dispozitat e parapara të ligjit nr. 03/L-231 nenin 17 paragrafin 12, IPK-DH kur konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin e punonjësve policor.

IPK-DH në këtë periudhë raportuese, ka realizuar gjithsej 22 arrestime (19 punonjës të Policisë së Kosovës dhe 3 qytetarë) nën dyshimin e arsyeshëm se kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale. IPK në vazhden e veprimeve hetimore, për interes të hetimit ka

⁶ Duhet të kihet parasysh se Raportet Informuese parashtrohen edhe në fazën e hetimit paraprak me numër të DMA-së, për udhëzime të mëtutjeshme nga Prokurori i Shtetit.

rekomanduar suspendimin e 91 punonjësve policor dhe transferimin e 4 punonjësve policor.

Në diagramin në vijim janë paraqitur numri i zyrtarëve të arrestuar, suspenduar dhe transferuar për vitet 2022-2024.




Divizioni për Mbështetje Teknike pranë DH-së, në përmbushje të detyrave edhe përgjegjësive hetimore, ka mbështetur në kryerje të detyrave Divizionet tjera hetimore, duke qenë pjesë e punëve të tyre, konkretisht në 7 raste, të cilat kanë pasur të bëjnë me natyrën e masave të fshehta, atë të hetimit të veçantë në përmbushjen e urdhërësive të lëshuara nga Gjykatat kompetente.


Divizioni për Inteligjencë dhe Analizë pranë DH-së, në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në vitin 2024, ka trajtuar gjithsejtë 190 informata, ku 118 informata kanë qenë të bartura nga viti paraprak, ndërsa ka arritur ti procedoj 25 informata, për hetim të mëtutjeshëm për Divizionet përkatëse në DH. Informata në proces dhe që vazhdojnë të trajtohen në vitin 2025 janë 165.

Departamenti i Hetimeve në vazhden e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive, pas hetimeve paraprake ka proceduar për hetim penal 138 raste në vitin 2024, përderisa prej tyre në Prokurorinë e Shtetit ka parashtruar 119 raste, ndërsa 19 raste në proces vazhdojnë të trajtohen në vitin 2025.


Diagrami në vazhdim pasqyron statusin e rasteve penale të trajtuara dhe proceduara vetëm të vitit 2024, si dhe trendët e krahasuara me dy vitet paraqike:



Duke ju referuar rasteve penale të trajtuara nga IPK në koordinim me Prokurorinë e Shtetit gjatë vitit 2024, në diagramin si në vijim gjeni të pasqyruara 5 veprat penale më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2024:



Gjatë viteve të fundit (2022-2024) pothuajse të njëjtat vepra penale kanë prirë në listën e 5 veprave penale më të shpeshta. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” për 4.1%, “Kanosje” për 6.2% dhe “Sulmi” për 27.2%, kanë trend rënie në vitin 2024, ndërsa trendi tek veprat penale si “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike” për 12% dhe “Lëndimi i lehtë trupor” për 13% në këtë vit kanë pësuar ngritje.



Gjatë vitit 2024, DH ka qenë e përkushtuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, në parandalimin dhe luftimin e veprimtarive penale të kryer nga punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të përfshirë me punonjësit e PK-së, e me theks të veçantë në luftimin e veprimtarisë korruptive.

Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare krahasuar edhe me dy vitet paraprake është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr. 8 - Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare				
Nr.	Lloji i veprës penale	2022	2023	2024
1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	39	24	23
2	Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	06	01	01
3	Përvetësimi në detyrë	02	01	01
4	Marrja e ryshfetit	03	00	01
5	Dhënia e Ryshfetit	00	01	01
6	Ushtrimi i ndikimit	00	02	01
7	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	00	00	05
8	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	00	00	02
	Gjithsej	50	29	35

Tabela nr. 9 në vijim pasqyron të dhënat e veprave penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2024, të ndara në kapituj duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Tabela nr. 9 - Lloji i veprave penale	Nr. i veprave
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (XIV)	
Neni 124 Spiunazhi	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit(XVI)	
Neni 172 Vrasja	1
Neni 173 Vrasja e rëndë	1
Neni 175 Vrasja nga pakujdesia	1
Neni 181 Kanosja	15
Neni 182 Ngacmimi	2
Neni 183 Ngacmimi Seksual	5
Neni 184 Sulmi	8
Neni 185 Lëndimi i lehtë trupor	23
Neni 186 Lëndimi i rëndë trupor	1
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (XVII)	
Neni 195 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike	25
Neni 200 Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial	1
Neni 202 Fotografimet dhe incizimet tjera të paautorizuar	1
Veprat penale kundër integriteti seksual (XX)	
Neni 227 Dhunimi	2
Veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI)	
Neni 248 Dhuna në familje	8
Veprat penale të narkotikëve (XXII1)	
Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge	2
Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge	1
Krimi i organizuar (XXIV)	
Neni 277 Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	2
Veprat penale kundër ekonomisë (XXV)	
Neni 294 Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm	1
Neni 296 Falsifikimi i parasë	1
Neni 311 Kontrabandimi i mallrave	1

Veprat penale kundër pasurisë (XXVI)	
Neni 318 Shpërdorimi i pasurisë së huaj	1
Neni 321 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	1
Neni 323 Mashtrimi	1
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë (XXVIII)	
Neni 356 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	3
Veprat penale të armëve (XXVIX)	
Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	1
Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	1
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik (XXX)	
Neni 370 Rrezikimi i trafikut publik	5
Neni 371 Ngasja në gjendje të pa aftë apo të dehur	2
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (XXXI)	
Neni 378 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre	1
Neni 382 Lajmërimi apo kallëzimi i rremë	2
Neni 384 Deklarimet e rreme	2
Neni 389 Manipulimi me prova	1
Neni 390 Falsifikimi i dokumenteve	1
Neni 393 Mospërfillja e gjykatës	1
Veprat penale kundër rendit publik (XXXII)	
Neni 401 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare	1
Neni 402 Sulmi ndaj personit zyrtar	1
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (XXXIII)	
Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	23
Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	1
Neni 418 Përvetësimi në detyrë	1
Neni 421 Marrja e ryshfetit	1
Neni 422 Dhënia e Ryshfetit	1
Neni 424 Ushtrimi i ndikimit	1
Neni 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	5
Neni 427 Falsifikimi i dokumentit zyrtar	2

Policia e Kosovës ka gjithsej 9900 punonjës, nga të cilët 9058 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa 842 janë personel civil pa autorizime policore.

Në tabelat me numër 10 dhe 11 në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 175 punonjësit policor dhe 15 qytetar të hetuar nga IPK-ja, ndarë sipas gradave të zyrtarëve që janë hetuar, si dhe krahasimi me dy vitet paraprake.

Tabela nr. 10 - Raporti në mes të numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe atyre të hetuar									
Të hetuarit sipas Gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Kadet	Shërbyes civil
Numri i punonjësve	27	43	80	144	309	848	7144	463	842
Numri i të hetuarve	0	0	0	2	10	22	132	1	8

Tabela nr. 11 - Pasqyra e të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve ndër vitet 2022-2024										
Të hetuarit sipas kategorive	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Kadet	Shërbyes civil	Qytetar
Viti 2022	0	0	1	4	7	17	215	0	13	//
Viti 2023	0	0	2	3	7	15	120	1	8	22
Viti 2024	0	0	0	2	10	22	132	1	8	15

Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga Drejtori dhe Zëvendësdyrëtorët e Përgjithshëm dhe 7 Departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 5733 punonjësve e ka Departamenti i Rendit Publik.

Departamenti i Rendit Publik përfshin 3 Divizione (Divizioni i Policimit në Bashkësi, Divizioni i Trafikut Rrugor dhe Divizioni i Sigurisë Publike) dhe 14 Drejtori duke i përfshirë edhe Drejtoritë Rajonale Policore. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga Departamenti i Rendit Publik.

Tabela në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK-ja, të ndarë në strukturën organizative policore si Drejtori dhe Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, Departamenti i Rendit Publik, Departamenti i Njësive Speciale, Departamenti i Kufirit, Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse.

Trendi i të hetuarve në Departamentin e Hetimeve, Rendit Publik, Njësive Speciale dhe Shërbimeve Mbështetëse ka ngritje të lehtë, ndërsa Departamenti i Kufirit ka ulje të lehtë.

Të gjitha të dhënat e lartpërmendura janë paraqitur në tabelën nr. 12 si në vijim:


Tabela nr. 12 – Pasqyra e numrit të punonjësve të hetuar sipas strukturës organizative.	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Drejtori dhe Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm	0	0	2
Departamenti i Rendit Publik	143	108	113
Departamenti i Njësive Speciale	///	11	16
Departamenti i Kufirit	97	24	21
Departamenti i Hetimeve	6	9	16
Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës	///	1	0
Departamenti i Burimeve Njerëzore	1	1	1
Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse	10	2	6

Bazuar në atë se Departamenti i Rendit Publik përbëhet nga 3 Divizione dhe 14 Drejtori, të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë pasqyrën e shpërndarjes së 113 punonjësve policor të hetuar në Departamentin e Rendit Publik.

Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin e Sigurisë Publike, ku janë strukturuar Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore.

Sipas të dhënave të IPK-së, vërehet një ngritje e lehtë e të hetuarve për 4.4% krahasuar me vitin paraprak ose për 5 punonjës më shumë. Të dhënat e lartcekura janë paraqitur në diagramin në vijim, ku shërbejnë punonjësit policor të hetuar.

Diagrami nr. 11 - Shpërndarja e punonjsve të hetuar në Departamenti e Rendit Publik




Gjatë vitit 2024 janë hetuar 111 punonjës policor të angazhuar në Drejtoritë Rajonale, ku DRP-Prishtina prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të hetuarve nga radhët e saj, duke pasur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore.


Ngritje e numrit të hetuarve krahasuar me vitin paraprak ka shënuar DRP-Mitrovicë Veri, DRP-Prizren, DRP-Ferizaj, DRP-Pejë dhe DRP-Gjakova, ndërsa ulje e numrit të hetuarve ka shënuar DRP-Prishtina, dhe DRP-Mitrovicë Jug kurse DRP-Gjilan qëndron me numër të njëjtë.

Diagrami në vazhdim paraqet pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në 8 Drejtoritë Rajonale Policore.

Diagrami nr. 12 - Shpërndarja e 111 punonjësve të hetuar nga IPK-ja punonjës nga Divizioni për Siguri Publike sipas drejtorive rajonale policore



Departamenti për Kufi, në organizimin e tij strukturor ka 2 Divizione, 7 Drejtori dhe Aeroportin e Prishtinës. Diagrami në vazhdim paraqet pasqyrën e shpërndarjes të 21 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar ku shërbejnë, krahasuar edhe me dy vite paraprake.



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2024 DH-ja ka trajtuar 53 raste, pas zhvillimit të hetimeve disiplinore, 40 raste janë proceduar me rekomandim për masën “Ndërprerje të marrëdhënies së punës”, 2 raste janë proceduar me rekomandim për masën “Degradim – jo më shumë se një gradë”, 2 raste janë proceduar me rekomandim për masën “Ndalesë në pagë mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj” dhe 3 raste janë proceduar me rekomandim për masën “Transfer disiplinor” ndërsa në 6 raste janë pushuar hetimet disiplinore.

Tutje, në kuadër të fushëveprimtarisë dhe gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë në Departamentin e Hetimeve, janë realizuar edhe shumë aktivitete tjera si zhvillimi i hetimeve proaktive me masa të fshehta hetimore, dalja në vend ngjarje, për incidentet të shkaktuar nga punonjësit policor e jo vetëm etj. Në këtë periudhë raportuese një pjesë e stafit të DH-së, kanë qenë të angazhuar në punë ekipore hetimore, po ashtu kemi asistuar Departamentin e Inspektimeve në një inspektim në nivel vendi.

Departamenti i Hetimeve për vitin raportues, ka zhvilluar bashkëpunimin të shkëlqyeshëm me të gjitha institucionet ligjzbatuese, si dhe bashkëpunime ndërkombëtare me institucione homologe.

7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit në kuadër të IPK-së funksionon nga korriku i vitit 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Inspektimit është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese . Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore. Kjo mbikëqyrje arrihet duke realizuar inspekte (të rregullta e të jashtëzakonshme). Inspektimi nënkupton vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave nga PK-ja, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara .

Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit janë: nxjerrja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit të përcaktuar me Ligjin për IPK-në, kryerja e inspekteve me iniciativë të vetën, ose me urdhër të Ministrit, sigurimi i informatave nga fushat menaxheriale përmes metodave të autorizuar të marrjes dhe sigurimit të tyre, analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore dhe hartimi i raporteve të inspektimit bazuar në standardet e raportimit.

Qëllimi i çdo inspektimi është, që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, parimet dhe procedurat zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet, të përcaktojë nëse burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj. Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit, të parandalojë shkeljet që mund të kryhen gjatë punës në fushë përkatëse. Të

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuar 12 inspekte të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluar qindra dosje administrative (penale, financiare, të prokurimit etj) dhe realizuar me dhjetëra intervista;
- Rekomanduar avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës;
- Verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.
- Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë.

identifikojë dobësitë - mangësitë dhe të rekomandojë masa për funksionimin më të mirë.

Departamenti i Inspektimit funksionon sipas Ligjit Nr. 03/L-231 për IPK-në. Mbi bazën e Ligjit është hartuar Udhëzimi Administrativ për Inspekte. Për të rregulluar procedurën e veprimet e personelit në përgatitjen, realizimin e inspektimit dhe raportimin, Departamenti përdorë edhe Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit e Raportimit.

Inspektorët udhëhiqen nga një varg parimesh, përfshirë këtu profesionalizmin, objektivitetin, paanshmërinë politike dhe mos diskriminimin. Inspektorët zhvillojnë aktivitetin e tyre në dy divizione: Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, si dhe në Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit. Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 9 punonjës me njohuri e aftësi të duhura në fushat e kontrollit policor që janë në kompetencë për inspektim. Gjatë vitit 2024, në nëntë (9) trajnime të mbajtura, kanë përfituar njohuri 22 pjesëmarrës.

Raporti vjetor pasqyron se si Departamenti i Inspektimit ka kryer funksionin e tij ligjor për periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2024. Departamenti i Inspektimit përcjellë rregullin mbi raportimin e përvitshëm mbi aktivitetet nga fusha operacionale, por edhe përfaqësimin dhe zhvillimin profesional.

Viti 2024 ishte produktiv për Departamentin e Inspektimit, me gjithë sfidat që vështirësuan arritjen e objektivave tona. Falë angazhimit të inspektorëve janë realizuar 12 inspektime, që kanë rezultuar me 63 rekomandime.

Departamenti përmbushë mandatin ligjor në përputhje me vlerat, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe të përqendruar në nevoja të përdoruesve të shërbimeve. Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë. Në përmbushje të misionit, jemi të përkushtuar në zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Këto vlera do të forcojnë besimin e publikut në Policinë e vendit.

Përgjatë periudhës afatmesme kohore 2022 - 2024 jemi orientuar nga Strategjia e IPK-së dhe Plani i saj i Veprimit, nga i cili burojnë edhe planet vjetore të punës. Këto dokumente që janë edhe në frymën e Programit qeveritar,

inspektimin e shohin si mekanizëm të duhur në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit në radhët e punonjësve policor. Planet tona bazohen në analiza të risqeve të identifikuar dhe mbi bazën e tyre realizohen inspektime që trajtojnë fusha me interes, fusha këto që mund të prodhojnë efekte negative në zhvillimin e duhur policor. Lidhur me këtë, Departamenti ka kompetencën dhe përgatitjen për të kontrolluar mbarëvajtjen e proceseve brenda Policisë.

Ne jemi të përkushtuar për përmirësimet e vazhdueshme profesionale, duke rishikuar kornizën inspektuese, politikat, procedurat tona, si dhe duke investuar në fuqinë tonë punëtore. Sa i përket kësaj të fundit, viteve të fundit kemi parasysh edhe profilizimin e personelit në fusha të caktuara, duke bërë që fushat inspektuese t'ua besojmë inspektorëve, varësisht prej afiniteteve të tyre. Për dallim nga vitet e kaluara, Departamenti i Inspektimit ka filluar të praktikojë edhe inspektime të shpejta në fusha të ngushta, duke gjeneruar raporte të shpejta. Inspektimi i stacioneve policore ka qenë po ashtu një risi në veprimtarinë tonë për të kuptuar performancën e disa prej tyre. Këto orientime do të na ndihmojnë të mbajmë rrugën e duhur për atë që duam të arrijmë. Ne do të rishikojmë strategjinë tonë për çdo vit për të siguruar që objektivat po na mbështesin për të përmbushur qëllimet për përmirësim të policimin në gjithë vendin.

Nuk duhet harruar edhe rolin e partnerëve që vazhdojnë të mbështesin Departamentin me programe trajnimi për zhvillim profesional dhe vizita studimore jashtë vendit.

AKTIVITETET OPERATIVE BREND A PROCESIVE TË INSPEKTIMIT

Inspektimi paraqet mekanizëm kontribues në ngritjen e përgjegjësisë për zbatimin e ligjit, përdorimin e drejtë të burimeve, ofrimin e shërbimeve cilësore, ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, lehtësimin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e transparencës ndaj publikut. Inspektimi po ashtu identifikon mangësitë në performancën policore të përcaktuar me ligjin përkatës dhe standardet e kërkuara.

Deri në konstatimin e një gjendje, nevojitet që të kalohet nëpër disa faza. Kjo bën të kuptohet se inspektimi është proces që domosdo kalon nga një fazë në tjetrën. Procesi i inspektimit nënkupton sistemin administrativ që duhet të përdoret nga IPK për të zhvilluar inspektime në Polici, për të garantuar se strukturat dhe personeli i saj operojnë në përputhje me ligjet, udhëzimet, rregulloret, parimet e procedurat e përcaktuara . Për të pasqyruar hapat nëpër të cilët kalon inspektimi, pasqyrojmë aktivitetet sipas fazave të procesit inspektues.

Planifikimi

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta

Faza e planifikimit ka përfshirë nxjerrjen e Planit Vjetor të Inspektimeve dhe Programeve të punës në frymën e Planit Strategjik. Këtë vit, Departamenti ka qenë pjesë aktive e procesit të rishikimit të Planit Strategjik Zhvillimor që parasheh aktivitetet inspektuese drejt zbatimit të mekanizmit parandalues të korrupsionit dhe keq-menaxhimit në Polici. Në fillim vit, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka përmbyllur procesin e Planifikimit Vjetor të Inspektimeve, ku ka identifikuar fushat me risk. Me planet e tashme vjetore parashihen dhe inspektime në fusha të ngushta me raporte të shpejta. Departamenti u ka ofruar akterëve (Ministritë, Policisë, IPK-së) të bëhen pjesë e procesit të planifikimit, për të siguruar një Plan cilësor, që adreson fushat me rëndësi dhe risk.

Sic parashihet në nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-231 të IPK-së, brenda tremujorit të parë të vitit, Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimit i ka dorëzuar Kryeshefit Ekzekutiv, Planin Vjetor të Inspektimit. Ky autoritet me datën 18 janar 2024 ka miratuar Planin , që ka marrë parasysh obligimet që dalin nga Strategjia, rëndësinë e programeve, risqet e identifikuar, rezultatet e inspektimeve të kaluar, kapacitetet njerëzore të Departamentit të Inspektimit dhe çështjet e pa trajtuara.

Për shkak të rritjes së kërkesave për inspektime të jashtëzakonshme, më 2 korrik 2024 është rishikuar Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2024), me çka ka ndryshuar agjenda inspektuese .

Programet e punës inspektuese

Mbi bazën e Planit Vjetor të Inspektimeve janë nxjerrë Programet e punës inspektuese. Para se të hartohen Programet e tilla sipas kornizës kohore të përcaktuar, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka kryer para-studim të fushave përkatëse, duke synuar të njohë më mirë veprimtarinë policore, të studiojë planet, legjislacionin, organizimin, burimet policore, aktivitetet dhe raportet policore. Programet e punës janë hartuar nga Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, dhe janë propozuar nga Udhëheqësi i Departamentit. Ato më pas janë miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së. Janë nxjerrë 12 Programe të punës inspektuese, mbi bazën e të cilave janë realizuar katër (4) inspektime të rregullta dhe tetë (8) të tjera të jashtëzakonshme:

- **Vlerësimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve operative të stacioneve policore (i jashtëzakonshëm);**
- **Vlerësimi i trajtimit dhe procedimit të rasteve të trafikimit me narkotikë (i jashtëzakonshëm);**
- **Vlerësimi i performancës së Stacionit të Prishtinë - Qendër (i rregullt);**
- **Menaxhimi i prokurimit dhe kontratave në Policinë e Kosovës (i rregullt);**
- **Vlerësimi i menaxhimit të procesit të gradimit për rreshter (i jashtëzakonshëm);**
- **Trajtimi i aksidenteve të trafikut nga Policia e Kosovës (i rregullt);**
- **Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës (i rregullt);**
- **Respektimi i ligjshmërisë gjatë konfiskimit të automjeteve në trafik (i jashtëzakonshëm);**
- **Vlerësimi i procesit të prokurimit për blerjen e mjeteve të blinduara (i jashtëzakonshëm);**
- **Përdorimi i kamerave të trupit dhe administrimi i provave digjitale (i jashtëzakonshëm);**
- **Vlerësimi i praktikave patrulluese dhe të ndaljes së mjeteve (i jashtëzakonshëm);**
- **Vlerësimi i punësimit jashtë detyrës zyrtare (i jashtëzakonshëm).**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektimi nr. 01/2024:

Vlerësimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve operative të stacioneve policore

Në vazhden e monitorimit të angazhimeve policore në të gjitha nivelet e organizimit, me datën 07.02.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm në stacione policore të rendit, për t'u siguruar se të njëjtat janë duke realizuar aktivitete policore në drejtim të krijimit të një ambienti më të sigurt për qytetarët. Objektivat e inspektimit kanë qenë vlerësimi i organizimit e kapaciteteve të angazhuara, vlerësimi i aktiviteteve operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, si dhe vlerësimi i kapaciteteve dhe kushteve të punës në stacione. Inspektimi është realizuar në 17 stacione policore të rendit publik. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me 17 mbikëqyrës të ndërrimeve në stacione, janë verifikuar kapacitetet aktive brenda ndërrimit, prezenca e patrullave policore, gjendja fizike dhe disponueshmëria e automjeteve. Po ashtu, janë siguruar edhe dokumente dhe të dhëna fizike/elektronike në funksion të raportimit. Lidhur me këtë inspektim janë dhënë pesë (5) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën përkatëse policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 02/2024

Vlerësimi i menaxhimit të procesit të gradimit për rreshter

Me kërkesë të Departamentit të Hetimeve (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 13.05.2024 ka autorizuar Departamentin e Inspektimit, që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Policisë së Kosovës, duke përfshirë edhe Drejtorinë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës, për të vlerësuar respektimin e rregullave/procedurave në procesin e fundit të gradimit për rreshter. Kërkesa ka pasqyruar shqetësimet mbi numrin e madh të ankesave të adresuar në IPK mbi rregullsinë e këtij procesi. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave/procedurave të gradimit, dhe vlerësimi i integritetit të procesit të aplikimit dhe testimit. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me pesë (5) drejtues dhe bartës të funksioneve në kuadër të strukturës së inspektuar, dhe janë kontrolluar dokumente të procesit të gradimit, duke përfshirë edhe 28 mostra të dosjeve të aplikantëve. Janë dhënë tetë (8) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 03/2024:

Vlerësimi i trajtimit dhe procedimit të rasteve të trafikimit me narkotikë

Me kërkesë të Departamentit të Hetimeve (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 27.02.2024 ka autorizuar Departamentin e Inspektimit që të realizoj inspektim të jashtëzakonshëm në Drejtorinë e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë, me theks të veçantë në dy Njësitë e Hetimit të Narkotikëve (Prizren e Gjakovë). Kërkesa për inspektim ka pasqyruar shqetësime nga burime të informacionit se në këto njësi ka probleme në trajtimin e rasteve dhe administrimin e dosjeve dhe provave. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave gjatë hetimit dhe procedimit të rasteve në Prokurorinë e Shtetit, dhe të identifikohet e vlerësohet mbajtja dhe mirëmbajtja e evidencave dhe dosjeve. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me tre (3) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturave policore të inspektuara dhe janë kontrolluar 64 dosje të rasteve. Janë dhënë 11 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 04/2024:

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Prishtinës (Qendër)

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta në vitin 2024 ka paraparë kryerjen e inspektimit për të vlerësuar performancën e Stacionit Policor të Prishtinës (Qendër), në vazhden e monitorimit të angazhimeve policore të këtij niveli të organizimit. Inspektimi ka synuar të pasqyroj përmbushjen e mandateve për të krijuar mjedis të sigurt për qytetarët. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, si dhe të vlerësohen kapacitetet dhe kushtet e punës në Stacion. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve brenda strukturave të stacionit, janë verifikuar masat e sigurisë, kapacitetet, procedurat, aktivitetet operative, si dhe janë siguruar edhe dokumente, përfshirë dhe 40 dosje të ndryshme disiplinore, operative, penale etj. Janë dhënë 13 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 05/2024:

Respektimi i ligjshmërisë gjatë konfiskimit të automjeteve në trafik

Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 06.08.2024 ka autorizuar inspektimin e jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar respektimin e legjislacionit në fushën e kundërvajtjeve të trafikut rrugor, gjatë konfiskimit të mjeteve me veprim motorik, për shkak të ngasjes së tyre gjatë periudhës sa janë aktive masat mbrojtëse ndaj kundërvajtësve “ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik”. Kërkesa për inspektim ka pasqyruar shqetësime të një numri të madh të ankuesve lidhur me pretendimet se konfiskimet e automjeteve, me të cilat janë shkaktuar kundërvajtjet, ndodhin edhe kur ato nuk janë pronë e kundërvajtësve. Inspektimi është fokusuar në Komisionin për Vendosje. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i bazës ligjore nga fusha e trafikut rrugor lidhur me konfiskimin e automjeteve me veprim motorik. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me tre (3) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës së inspektuar dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit, përfshirë dhe pesë (5) dosje të rasteve të trajtuara. Janë dhënë tre (3) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 06/2024:

Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit për vitin 2024 ka paraparë kryerjen e inspektimit për të vlerësuar performancën e stacioneve policore, në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ka disa vite që IPK po ndërmerr inspektime në këtë fushë, për të vlerësuar aktivitetet policore në parandalimin dhe luftimin e këtij krimi, që vazhdon të jetë prezent në shoqëri. Inspektimi është fokusuar në stacionet policore të kategorive A, B dhe C. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohen kapacitetet policore për trajtimin e rasteve, të vlerësohet reagimi dhe hetimi i rasteve, të vlerësohen aktivitetet në monitorimin e urdhrave mbrojtës, si dhe të vlerësohet përmbajtja e dosjeve dhe evidencave. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me 12 shefat e sektorëve të hetimeve në stacione policore, është verifikuar funksionimi i databazës së të dhënave mbi procedimin e lëndëve në Prokurori të Shtetit dhe logjet ditore, si dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit, përfshirë dhe 23 dosje të rasteve. Janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 07/2024:

Përdorimi i kamerave të trupit dhe administrimi i provave digjitale

Më 28.10.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar inspektimin e jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar nivelin e përdorimit të kamerave të trupit nga përdoruesit e autorizuar dhe administrimin e audio-video materialeve të regjistruara. Këto pajisje janë pranuar si donacion i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si mbështetje për reformën e sistemit të drejtësisë, ngritjen e sigurisë, avancimin e llogaridhënies, etj. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i legjislacionit për përdorimin e kamerave të trupit, të vlerësohet administrimi i pronës së pranuar si donacion, të vlerësohet efektiviteti në funksionimin e tyre, të vlerësohet efekti i tyre në ngritjen e sigurisë/transparencës/llogaridhënies dhe performancës, si dhe të vlerësohen masat e sigurisë lidhur me administrimin e provave digjitale. Inspektimi është përqendruar në Departamentin për Kufi, Departamentin e Rendit Publik dhe Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me 14 drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturave të inspektuara, janë kryer verifikime të prezencës së kamerave dhe pajisjeve përcjellëse, përdorimit të tyre, funksionimit të sistemit, si dhe janë siguruar dokumente në funksion të inspektimit. Janë dhënë tetë (8) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 08/2024

Vlerësimi i praktikave patrulluese dhe të ndaljes së mjeteve

Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 19.12.2024 ka autorizuar inspektimin e jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikën patrulluese dhe ndaljes së mjeteve nga ekipe patrulluese të NJRTRR-Gjilan. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohen praktikat e patrullimit dhe mbikëqyrjes së trafikut, si dhe të identifikohen e vlerësohen masat e sigurisë gjatë patrullimit dhe kontrollit të mjeteve. Gjatë inspektimit është zhvilluar takim me Shefin e NJRTRR-Gjilan, janë kryer verifikime të prezencës së patrullave, vendosjes së pikave të kontrollit, masave të sigurisë gjatë ndaljes dhe kontrollit të mjeteve, si dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit. Përmes raportit të inspektimit, janë dhënë dy (2) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 9/2024

Trajtimi i aksidenteve të trafikut nga Policia e Kosovës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit për vitin 2024 ka paraparë realizimin e inspektimit në fushën e trajtimit të aksidenteve të trafikut. Inspektimi ka synuar të vlerësojë nëse njësitë rajonale të trafikut kanë kapacitete të mjaftueshme për të realizuar detyrat në kuadër të përgjegjësisë, për të menaxhuar me aksidente dhe për të ngritur sigurinë rrugore në përgjithësi. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohen kapacitetet operationale të këtyre njësive, të matet dhe vlerësohet koha e reagimit në thirrjet për aksidente, të vlerësohen veprimet në trajtimin e aksidenteve, si dhe të vlerësohet administrimi i dosjeve të aksidenteve. Inspektimi është përqendruar në të gjitha njësitë rajonale të trafikut dhe NJKA. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me nëntë (9) shefat e njësive të trafikut rrugor, është verifikuar gjendja dhe disponueshmëria e pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe janë siguruar 80 mostra (dosje) të aksidenteve. Janë dhënë shtatë (7) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 10/2024

Punësimi jashtë detyrës zyrtare

Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 19.12.2024 ka autorizuar inspektimin e jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikën e punësimit të punonjësve policor jashtë detyrës zyrtare. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave të punësimit jashtë detyrës zyrtare, si dhe respektimi i orarit të rregullt të punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me dy (2) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës së inspektuar, është verifikuar prezenca në punë, si dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit.

Inspektimi nr. 11/2024

Vlerësimi i procesit të prokurimit për blerjen e mjeteve të blinduara

Me kërkesë të Ministrit të Punëve të Brendshme, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 21.10.2024 ka autorizuar inspektimin e jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar respektimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik lidhur me blerjen e mjeteve të blinduara. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave të prokurimit, të vlerësohet efikasiteti dhe leverdia ekonomike në kontratat e lidhura, si dhe të vlerësohet përmbushja e kushteve kontraktuale. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me tre (3) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës së inspektuar, dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit, përfshirë dhe dy (2) dosje të prokurimit dhe financiare.

Inspektimi nr. 12/2024

Menaxhimi i prokurimit dhe kontratave në Policinë e Kosovës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit për vitin 2024 ka paraparë realizimin e inspektimit në fushën e menaxhimit të prokurimit dhe kontratave. Inspektimi ka synuar që të vlerësohet nëse Policia është orientuar në shfrytëzimin racional dhe të drejtë të fondeve që i janë besuar, kur kihet parasysh se shuma të mëdha financiare shpenzohen në mallra, shërbime dhe punë. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave të prokurimit, të vlerësohet efikasiteti dhe leverdia ekonomike në kontratat e lidhura, si dhe të vlerësohet përmbushja e kushteve kontraktuale. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime me dy (2) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës së inspektuar, dhe janë siguruar dokumente në funksion të raportimit, përfshirë dhe 30 dosje të prokurimit dhe financiare.

8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim (DPBÇLI) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë:

- udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike;
- siguron shërbime juridike/këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale;
- udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin- plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së;
- udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit;
- udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushëne komunikimit dhe informimit publik;
- udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM, BASHKËPUNIM, ÇËSHTJE LIGJORE DHE INFORMIM

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi 100 Komunikata dhe publikime të ndryshme,
- Ofruam informacione për medie në mbi 180 kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore etj.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;
- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar pesë (5) punonjës.

IPK-ja gjatë vitit 2024 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Plani Zhvillimor Strategjik 2022 - 2024 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes DPBÇLI-së.

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e PSO-ve etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare.

a) Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar mbi numrin e kërkesave të trajtuara.



Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, këtë vit Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj priti në takim Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, së bashku me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Xhelal Sveçla.

Gjatë këtij takimi z. Hodaj e informoi Kryeministrin Kurti për punën dhe të arriturat e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Temë e diskutimit ishin edhe trajtimi i ankesave të qytetarëve, inspektimet si dhe angazhimet tjera të IPK-

së drejt fuqizimit të integritetit policor.

Në fund të takimit Kryeshefi Hodaj e falënderoi Kryeministrin Kurti për vizitën dhe përkrahjen e vazhdueshme që Qeveria ka dhënë në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së, si një mekanizëm i rëndësishëm i sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.



Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti kanë fuqizuar bashkëpunimin me Prokurorinë e Shtetit në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera të penale. Kjo ka ndikuar që IPK dhe Prokuroria e Shtetit zhvillojnë raporte të bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative, të cilat hasen në Polici, e në veçanti në luftimin e korrupsionit, përmes shkëmbimit të informatave dhe trajtimit të tyre mbi dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policorë.

Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse.



Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Inspektorati Policor i Kosovës respektivisht përfaqësuesit e saj kanë mbajtur prezantim/ligjërata para kadetëve të Gjeneratës së 59 dhe 60 të Policisë së Kosovës e cila ka vijuar trajnimin bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri. Ligjërata respektivisht prezantimi me temën “Roli dhe misioni ligjor i IPK-së”

është mbajtur me secilën klasë të kadetëve të cilët kanë vijuar trajnimin themelor në AKSP.

Realizimi i aktivitetit të tillë ka për qëllim që IPK të jep informacione shtesë lidhur me rolin, misionin dhe për fushë-veprimtarinë e saj si dhe pritet të ketë ndikim pozitiv edhe në aspektin e preventivës gjenerale dhe fuqizimit të integritetit të zyrtarëve të PK-së.

Përveç prezantimit, ligjëruesit e IPK-së ndanë edhe përvojën e tyre me kadetët e rinj në funksion të fuqizimit të integritetit për profesionin fisnik të zyrtarit policor për zbatimin e ligjit në Kosovë.

b) Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

Varësisht sipas nevojave operative në terren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit nga DPBÇLI në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media,
- dhënia e deklaratave për mediet,
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun,
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së,
- kërkesat për qasje në dokumente publike etj.
- Përgatitja e Planit vjetor të IPK-së.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë trajtuar me qindra kërkesa përmes telefonatave të ndryshme nga mediat, mbi 180 kërkesa me shkrim të adresuara në adresën zyrtare të Divizionit për bashkëpunim dhe informim (DBI) si dhe janë publikuar më shumë se 100 komunikata për medie dhe publikime tjera lidhur me aktivitetet e ndryshme të IPK-së.

Përveç këtyre angazhimeve ky Divizion ka përgatitur në baza të rregullta analizën – raportin e shtypit ditor lidhur me ngjarjet që janë mbuluar nga mediat dhe i cili është shpërndarë te zyrtarët e IPK-së.

DBI ka administruar dhe ka përditësuar edhe rrjetet sociale me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë e cila është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare është publikuar edhe në Facebook duke rritur në këtë mënyrë edhe numrin e ndjekësve në këtë rrjet social.



Në kuadër të angazhimeve për fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, Inspektorati Policor i Kosovës respektivisht përfaqësuesit e saj kanë marrë pjesë në dy diskutime publike me banorë, përfaqësues të organizatave jo-qeveritare dhe atyre të shoqërisë civile në Mitrovicën e Veriut. Ky aktivitet u organizua me përkrahjen e OJQ – së ACDC - Qendra Avokuese për Kulturë Demokratik dhe u mbajt në “Qendrën për Energji Qytetare” në Mitrovicën e Veriut.

Qëllimi i këtyre diskutimeve ishte që banorët e

kësaj pjese si dhe OJQ-të dhe shoqëria civile të kenë njohuri shtesë mbi rolin dhe misionin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Gjatë këtij diskutimi publik u prezantua puna e IPK-së, mandati, fushëveprimtaria dhe juridiksioni me synim që të fuqizohet ndërgjegjësimi për rolin e IPK-së dhe bashkëpunimi me qytetarë.

IPK ka realizuar edhe aktivitete – takime të përbashkëta me qytetarët e Janjevës dhe Letnicës.

Synimi i këtij aktiviteti me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë, përveç pjesës së fuqizimit të bashkëpunimit me qytetarë, ishte edhe i ngritjes së vizibilitetit të organizatës lidhur me fushëveprimtarinë e IPK-së në përgjithësi, trajtimit të ankesave të qytetarëve, inspektimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme etj.



Këto aktivitete janë realizuar në bashkëpunim me Komitetin Lokal për Siguri Publike (KLSP) të Janjevës dhe me ndihmën e ICITAP-it.



Me ndihmën e ICITAP-it u realizuan edhe aktivitete me studentët dhe stafin në Prizren në shkollat e mesme mjekësore “Luciano Motroni” dhe “Gjon Buzuku”. Më shumë se 100 nxënës shprehën mirënjohjen për vizitat e Atasheut Kimberly Riffe nga Departamenti i Drejtësisë i Ambasadës së SHBA-së- Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale (DD-ICITAP) dhe Kryeshefit Ekzekutiv z. Kushtrim Hodaj nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).

Publikimi i revistës “Integriteti” dhe buletinit mujor “Linja e Kaltër”



Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2024 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.

Përveç revistës “Integriteti” në vitin 2024 IPK respektivisht Divizioni për bashkëpunim dhe informim ka vazhduar me projektin që i referohet fuqizimit të transparencës së brendshme duke publikuar çdo muaj buletin e titulluar “Linja e Kaltër”.

c) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me ICITAP-in



IPK-ja çmon lartë bashkëpunimin me ICITAP-in, i cili është i rëndësishë së veçantë. ICITAP ka ndihmuar IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Trajnimet që ka ofruar ICITAP-i ndër vite, kanë qenë mëse të nevojshme për IPK-në dhe të duhura për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK është përkrahur me trajnime specifike që kanë fuqizuar kapacitetet profesionale.

Inspektorati Policor i Kosovës në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan dhe CIDS-in (Center for Integrity in the Defense Sector - Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) organizoi në Prizren konferencën rajonale dy ditore me temën “Fuqizimi i bashkëpunimit të shërbimeve të kontrollit të brendshëm në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimit të praktikave të mira”.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin zyrtarë të lartë nga institucionet homologe të mbikëqyrjes policore të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut e që njëherit janë edhe anëtarë të Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishte edhe Atasheja e ICITAP-it pranë Ambasadës Amerikane në Kosovë znj. Kimberly Riffe

dhe përfaqësuesit e ICITAP-it nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Ndër temat e trajtuara gjatë punimeve të konferencës ishin ato që ndërlidhen me fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve të kontrollit të brendshëm të vendeve të rajonit lidhur me përgjegjëshmërinë dhe integritetin e policisë .

Pjesë e diskutimit të konferencës ishin edhe planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta që pritet të realizohen në kuadër të Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore që u themelua në Prishtinë verën e vitit të kaluar si dhe pati diskutime për draft statutin e këtij Forumi.

Nga ky takim u shkëmbyen shumë përvoja dhe ide për të avancuar bashkëpunimin dhe fuqizimin e integritetit në fushën e kontrollit policor.

Kryeshefi i IPK-së, Kushtrim Hodaj dhe ekipi i tij me përkrahjen e ICITAP-it morën pjesë në konferencën vjetore të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Washington të SHBA-ve.





Në vitin 2024, IPK ishte organizata e parë ndërkombëtare që prezantoi në konferencën vjetore të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Uashington, D.C. Kryeshefi Hodaj dhe hetuesi Hazer Mallaku prezantuan operacionin “PIKA 1 dhe PIKA 2” dhe suksesin në përpjekjet kundër korrupsionit. Prezantimi krijoi interes të konsiderueshëm dhe dialog midis 304 pjesëmarrësve që përfaqësonin tetë vende, përfshirë Shtetet e Bashkuara. Para konferencës, delegacioni u takua me zyrtarë kryesor në zyrat e Operacioneve Ndërkombëtare dhe Punëve të Brendshme të FBI-së, Byronë e Departamentit të Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit

(INL) – duke përfshirë Drejtorin e INL-së, Receptionisti, Zyrtarin e Programit për Kosovë- dhe përfaqësues nga selia e Programit të Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Penale Ndërkombëtare të Departamentit të Drejtësisë (ICITAP).

Me përkrahjen e ICITAP-it, Kryeshefi i IPK-së Kushtrim Hodaj dhe zyrtarë të institucioneve të tjera të Kosovës, morën pjesë në konferencën vjetor të Shoqatës Ndërkombëtare të Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST) në Phoenix, Arizona.

Delegacioni u mbështet dhe u shoqërua nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnim për Hetimet Kriminale të Departamentit të Drejtësisë (ICITAP), Atasheu Kimberly Riffe. Kjo ngjarje filloi me një prezantim të flamurit të 23 vendeve të përfaqësuara nga mbi 400 pjesëmarrësit në konferencën katër-ditore. Përveç pjesëmarrjes në seminarin e mjekësisë ligjore, delegacioni nga Kosova përcjelli dy seminare të paraqitura nga komandantet femra ukrainase mbi mirëqenien/shëndetin mendor dhe shoqatat e grave të zbatimit të ligjit.



Për më tepër, delegacioni në fjalë mori pjesë në trajnime interaktive mbi inteligjencën artificiale (AI), mediat sociale dhe rekrutimin, ndër të tjera.

Bashkëpunimi me OSBE-në

Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2022 ka ofruar përkrahje për IPK-në me trajnime të specializuara dhe aktivitete të ndryshme. Në kuadër të kësaj përkrahjeje, zyrtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) kanë përfunduar me sukses një trajnim njëjavor të përqendruar në hetimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Në këtë trajnim u përfshi edhe ekspertiza e një konsulenti ndërkombëtar me përvojë të gjerë në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke sjellë praktikat më të mira dhe qasjet e avancuara hetimore për pjesëmarrësit. Trajnimi mbuloi tema të rëndësishme që përfshijnë ndikimin e korrupsionit, duke u përqendruar në kostot dhe pasojat që ky fenomen sjell për shoqërinë dhe institucionet. IPK gjatë këtij viti u përkrah edhe me trajnime të tjera të rëndësishme nga Misioni i OSBE-së duke u fuqizuar në fushën e menaxhimit të prokurimit, vlerësimit të rreziqeve, trajnimit për statistika etj.



Në kuadër të bashkëpunimit me Misionin e OSBE-së, IPK priti në një takim Ushtruesen e Detyrës së Shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë znj. Cornelia Taylor dhe bashkëpunëtorë të saj.

Temë e diskutimit ishin aktivitetet për të mbështetur IPK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale, përmes trajnimeve dhe aktiviteteve që mbështesin planet zhvillimore dhe strategjike të IPK-së.

Bashkëbiseduesit u pajtuan për realizimin e shumë aktiviteteve që kontribuojnë në forcimin e integritetit dhe llogaridhënien në radhët e policisë, me synimin e përbashkët për të ofruar siguri dhe adresim të shqetësimeve të gjithë qytetarëve pa dallim.

Bashkëpunimi me EPAC-un

Përfaqësuesit e IPK-së morën pjesë në Konferencën Profesionale Vjetore dhe Asamblenë e Përgjithshme të EPAC/EAC - Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit (European Partners Against Corruption and Eurpian) e cila u mbajt në Bukuresht të Rumanisë.



Pjesë e kësaj konference ishin Agjencitë Mbikëqyrëse të Policisë dhe Agjencitë Antikorrupsion të Evropës. Konferenca mbuloi diskutime për mundësitë e bashkëpunimit në hetimin e korrupsionit, mjetet dhe zhvillimet në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, trajnimet për ndërtimin e integritetit në institucionet e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrjen policore.

Kryeshefi Hodaj dhe delegacioni i IPK-së takuan Presidentin e EPAC/EACN z. Linas Pernavas dhe udhëheqës të shumë institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe Antikorrupsionit nga Evropa të cilët ishin pjesë e konferencës.

Bashkëpunimi rajonal

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), me përkrahjen e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), këtë vit ka organizuar një seminar dhe vizitë studimore tre-ditore, duke mbledhur përfaqësues të agjencive mbikëqyrëse policore nga tri shtete të rajonit: Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.



Ky aktivitet i karakterit rajonal është organizuar në kuadër të aktiviteteve të Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore që është themeluar vitin e kaluar me nënshkrimin e marrëveshjes për këtë forum nga përfaqësuesit e agjencive të katër shteteve të rajonit:

Republika e Kosovës, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Seminari kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të agjencive mbikëqyrëse policore në rajon përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira. Një synim

tjetër i seminarit ishte edhe fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal në mbikëqyrjen e punës policore dhe krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm profesional ndërmjet agjencive pjesëmarrëse.

Më 7 dhe 8 nëntor, në qytetin bregdetar të Budvës- Mali i Zi, u mbajt takimi i Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

Ky takim u organizua me mbështetjen e CIDSD-it (Center for Integrity in the Defense Sector - Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) dhe ICITAP-i.

Takimi shërbeu si një platformë e rëndësishme për të ndarë përvojat, për të diskutuar sfidat dhe për të forcuar bashkëpunimin rajonal mes agjencive të mbikëqyrjes policore në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.



9. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET E PËRGJITHSHME

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (DFSHP) ka rol mbështetës në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të Teknologjisë Informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DFSHP-së janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK-së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, siguron zbatimin e procedurave për për zgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së, koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së, menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së, ofron shërbime logjistike për IPK-në, menaxhon, administron, mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

DFSHP ka të punësuar 23 punonjës dhe është i strukturuar në tre divizione:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 96.18 %;
- Menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Teknologjisë Informative;
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së;
- Realizimin e Planit të dalë nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Ofruam shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam 92.92 % të tij;

Vazhduam ndërlidhjen e data bazave me Policinë e Kosovës dhe ARC-në;

Organizuam trajnime bazuar në Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së;

Vazhduam projektin Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së përmes sistemit SEMA.

Shtuam flotën e automjeteve të IPK-së mbi 15%

Misioni kryesor DFSHP-së, është menaxhimi i drejtë, efikas dhe me nikoqirllëk me parat publike për nevojat e IPK-së, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin me Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194, si dhe me rregulloret dhe udhëzimet administrative financiare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të arritjes së misionit dhe objektivave të parapara të IPK-së.

Tabela me të dhënat finale të buxhetit dhe shpenzimeve

Nr.	Kategoria ekonomike	Buxheti final SIMFK	Shpenzimet	Mbetja	% e realizimit
1	Pagat dhe shtesat	918,082.25	917,166.19	916.06	99.90
2	Mallra e shërbime	573,367.00	460,401.93	112,965.07	80.30
3	Shpenzime komunale	11,551.00	9,655.21	1,895.79	83.59
4	Projekte kapitale	220,247.00	213,992.47	6,254.53	97.16
Gjithsej:		1,723,247.25	1,601,215.80	122,031.45	92.92

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 92.82 %;
- Menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Teknologjisë Informative;
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së;
- Realizimin e Planit të dalë nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

Gjithashtu, DTISHL/DFSHP ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku në vazhdimësi ka trajtuar kërkesat për servisimin e automjeteve, ka hartuar autorizimet, si dhe ka bërë sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve, inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të flotës dhe po ashtu ka vazhduar të mbaj të dhënat në kartelë fizike dhe elektronike mbi gjendjen e secilit automjet të IPK-së.

IPK çdo herë i ka kushtuar rëndësi të veçantë ndërtimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj përmes trajnimeve të ndryshme. Edhe këtë vit ka vazhduar përkrahja e fuqishme e ICITAP-it dhe Ambasadës Amerikane në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të IPK-së përmes trajnimeve dhe vizitave studimore në SHBA. Krahas ICITAP-it, IPK ka pranuar përkrahje në fushën e trajnimit edhe nga Misioni i OSBE-së në fusha të rëndësishme për realizimin e misionit ligjor të saj.

IPK falënderon partnerët ndërkombëtar dhe ata vendor (AKSP dhe IKAP) për përkrahjen e vazhdueshme drejt fuqizimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj. Tabelat në vijim prezantojnë numrin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve në trajnimet për stafin operativ dhe atij administrativ të IPK-së.

TRAJNIMET/ PUNONJËSIT OPERATIV- 2024				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Pjesëmarrës
1	Publik Corruption and Financial Analysis	ICITAP	Shkurt	3
2	Surveillance Operations Course	ICITAP	Mars	3
3	Program on Countering Transnational Organized Crime	Gorge M	Shkurt Mars	1
4	Confidential Informants Development course - DEA	ICITAP	Prill	4
5	Hetimi e Krimet të Jakave të Bardha dhe Valuta Virtuale	ICITAP	Maj	2
6	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	AD	Maj	3
7	Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve	AD	Maj	2
8	Reagimi dhe hetimi i rasteve të plaçkitjeve	ICITAP	Maj	1
9	Mbrojtja e të dhënave personale	AD	Maj	1
10	Quality Assurance Knowledge Exchange and Training	ICITAP	Maj	1
11	Surveillance Course- DEA	ICITAP	Qershor	2
12	Krimi kibernetik dhe kriptovalutat	AD	Qershor	4
13	Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave	AD	Qershor	2
14	Kursi Bazik i Operacioneve të Fshehta	ICITAP	Qershor	4
15	Trajnimi për Trajner	IKAP	Korrik	1
16	National Affairs Investigators Association	ICITAP	Gusht	5
17	Pastrimi i Parave dhe Hetimi Financiar	AD	Shtator	4
18	Trajnimi për Statistika	OSCE	Shtator	9
19	Shqyrtimi paraprak i padisë në kontekst të pengimit, posedimit, fyerjes dhe shpifjes- afatshmeria, lejueshmëria- prezumimi procedural	AD	Shtator	3
20	Policimi i Drejtuar nga Inteligjenca	Ambasada Angleze	Shtator - Nëntor	8
21	Hetimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit	OSCE	Tetor	14
22	Teknikat e Avancuara Analitike	Ambasada Angleze	Tetor	4
23	Mbrojtjen e të dhënave	EU	Tetor Nëntor	2
24	Menaxhimin e prokurimit dhe kontratave për IPK	OSCE	Nëntor	2
25	Trajnimi për Instruktor të Armëve të Zjarrit	PK/AKSP	Dhjetor	3
26	Vlerësimi i rrezeve të përputhshmëri me punën e policisë	OSCE	Dhjetor	15
27	Bazat e mbrojtjes së të dhënave	AIP	Dhjetor	1

TRAJNIMET/ PUNONJËSIT ADMINISTRATIV- 2024					
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Ditët	Pjesëmarrës
1	Trajnimi për Statistika	OSCE	Shtator	5	1
2	Hetimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit	OSCE	Tetor	5	1
3	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	IKAP	Nëntor	2	1
4	Menaxhimin e prokurimit dhe kontratave për IPK	OSCE	Nëntor	5	8



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR 2024



**INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO**

**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

|0800003333| RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE

**SË BASHKU PËR NJË POLICI PROFESIONALE
ZAJEDNO ZA PROFESIONALNU POLICIJU
TOGETHER FOR PROFESSIONAL POLICE**

**IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION**